



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 54 datë 27.11.2020**

**“PËR MIRATIMIN PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË  
KLUBIT TË FUTBOLLIT “VLLAZNIA” SHA NË MASËN 100%”**

Keshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2020, me propozim të Kryetares së Bashkisë, në mbështetje të nenit 113, pika 2 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 54 gërma “e” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Ligjit nr.105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”, nenit 8; Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar; Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar; VKM nr. 1719, datë. 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar; VKB nr.9, datë 26.08.2011 “Për miratimin e transferimit të Klubit të futbollit “Vllaznia” në shoqëri aksionare”, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, me 39 vota Pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për shpalljen për shitje të 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotëron si aksionere e vetme në Shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia”.
2. Çmimi minimal i shitjes së 100% të kuotave është 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) Lekë.
3. Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Shkodër në Shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia”, të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese: Procedurë e Hapur Standard e Ankandit, sipas dokumenteve standarde tip të ankandit, bashkëngjitur këtij vendimi.

4. Procedura e ankandit për shitjen e 100% të aksioneve, që zotëron Bashkia Shkodër, të nisë me vlerën 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) Lekë.
5. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.



**Sekretar i Këshillit**

  
Denis Lesha

**KRYETARE**

  
  
Elisela KADIJA